VENDIM
Nr. 54, datë 2.9.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR MBIKËQYRJEN E KONSOLIDUAR"

(ndryshuar me vendimin nr. 41, datë 4.8.2021)

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nënkreut II, të kreut VI, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për mbikëqyrjen e konsoliduar", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 1.2.2017, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në aneksin 4 të rregullores, formularët 1 deri në 5 zëvendësohen me një formular të vetëm, formularin 1, dhe me udhëzimet shpjeguese për plotësimin e tij, sipas përmbajtjes bashkëlidhur këtij vendimi;

b) në aneksin 5, formulari nr. 2, "Raportet dhe nivelet e kapitalit (i konsoliduar)", ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

RAPORTET DHE NIVELET E KAPITALIT (I KONSOLIDUAR)

Nr.	Zëra	Vlera
1.	Raporti: Kapitali bazë i nivelit të parë/ekspozime të ponderuara me rrezikun	≥6.75%
2.	Raporti: Kapitali i nivelit të parë/ekspozime të ponderuara me rrezikun	≥9%
3.	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	≥12%

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të shkronjës "a" të pikës 1, e cila hyn në fuqi *më 1 janar 2022*.

KRYETAR
Gent Sejko

ANEKSI 4

Formulari raportues për ekspozimet e mëdha mbi baza të konsoliduara (referuar rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave") - (çdo tremujor)

Formulari 1

Nr.	Data e raportimit	Emri i bankës mbizotëruese	Tipologjia e ekspozimit	Emërtimi i grupit të palëve të lidhura	Numri i klientit në varësi të tipologjisë së ekspozimit	Tipologjia Kontabël e	Renditja e ekspozimeve	Renditja e ekspozimeve më të mëdha të grupit ndaj institucioneve të Mbikëqyrura	Emri i klientit	NUIB / Numër identifikimi	Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (vetëm për ZLB)	Pozicione në instrumente finanoiare (vetëm për ZLT)		
												Në blerje	Në shitje	Në blerje neto
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14 = 12 - 13
1														
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														
11														
12														
13														
14														
15														
16														
17														
18														
19														
20														
21														
22														
23														
24														
25														
26														
27														
28														
29														
30														
31														
32														
33														
34														
35														
36														

Pozicionet në instrumente financiare në raste të ndërshkrimit me premtimin për të blerë (vetëm për ZLT)			Ekspozimi i rrezikut të kredisë së kundërpartisë (vetëm për ZLT)	Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (vetëm për ZLT)	Ekspozimi përgjithshëm përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (ZLB+ZLT)	Nga i olli (20): Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë i ardhur nga zëvendësimi	Nga i olli (20): Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë i ardhur nga shuma e kredive (vetëm për ekspozimet e kategorive IMLG, GIMLG, KILG dhe GPLG)	Përqindja ndaj kapitalit rregullator të grupit përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Përqindja ndaj kapitalit të nivelit të parë të grupit përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Mbrojtja e pafinancuar e kredisë	Mbrojtja e financuar e kredisë	Përjashtime dhe reduktime
Premtimi për të blerë	Transferuar një personi të tretë	Diferenca										
15	16	17 = 15 - 16	18	19 = 14 + 17 + 18	20 = 11 + 19	21	22	23 = 20 / 30	24 = 20 / 31	25	26	27

Ekspozimi pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë për ZLB	Ekspozimi i përgjithshëm pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Kapitali rregullator i grupit në datën e raportimit	Kapitali i nivelit të parë të grupit në datën e raportimit	Përqindja ndaj kapitalit rregullator, pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Përqindja ndaj kapitalit të nivelit të parë, pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Kufiri maksimal i lejueshëm	Tejkalimet e kufirit maksimal të lejueshëm	Ekspozimet e mëdha që janë mbi 10% e kapitalit rregullator të grupit	Matja e shumës së ekspozimeve të mëdha që janë mbi 10% e kapitalit rregullator të grupit	Matja e ekspozimeve të kredive për kategoritë e kundërpartive të lidhura me grupin (IMLG, GIMLG, KILG dhe GPLG)
28 = 11 - (25 + 26 + 27)	29 = 20 - (25 + 26 + 27)	30	31	32 = 29 / 30	33 = 29 / 31	34	35	36	37	38

Udhëzues shpjegues për plotësimin e formularit 1

Numri i kolonës	Emri i Kolonës	Përshkrimi i përmbajtjes
1	Data e raportimit	Përzgjidhet data e raportimit sipas periudhës raportuese.
2	Emri i bankës mbizotëruese	Përzgjidhet emri i bankës sipas shkurtimeve të mëposhtme.
		BA - Banka Alpha
		BAI - Banka Amerikane e Investimeve
		BBSH - Banka e Bashkuar e Shqipërisë
		BC - Banka Credins
		BKT - Banka Kombëtare Tregtare
		BPC - Banka ProCredit
		BPI - Banka e Parë e Investimeve
		BR - Banka Raifeisen
		BT - Banka Tirana
		BU - Banka Union
		IBPB - Banka Intesa San Paolo
		OTP - Banka OTP
3	Tipologjia e ekspozimit	Përmban kategorizimin e ekspozimit në varësi të kundërpartisë, siç është përcaktuar në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha". Kolona do të plotësohet në bazë të kritereve të parapërcaktuara. Lista e kategorizimittë kundërpartisë jepet më poshtë. Për secilën prej kundërpartive do të ketë një numër rendor për të dalluar kundërpartitë e së njëjtës tipologji. Kjo kolonë do të plotësohet për të gjitha ekspozimet. Në rastet kur më shumë se një ekspozim i përket një grupi të lidhur, për kodet GPL, GIML, GIMLG, GPLG, për secilin nga ekspozimet do të plotësohet i njëjti kod me të njëjtin numër rendor.
	KI	Klient individual
	GPL	Grup Personash të Lidhur
	IMI	Institucione të Mbikëqyrura individuale
	GIML	Grup Institucionesh të Mbikëqyrura të Lidhura
	IMLG	Institucione të Mbikëqyrura me marrëdhënie të veçantë (Lidhuri me Grupin
	GIMLG	Grup Institucionesh të Mbikëqyrura me marrëdhënie të veçantë (Lidhuri me Grupin
	KILG	Klient individual me marrëdhënie të veçantë (Lidhuri me Grupin
	GPLG	Grup Personash me marrëdhënie të veçantë (Lidhuri me Grupin
	QQ	Qeveri Qendrore
	BQ	Banka Qendrore
	ON & BBhZh	Organizata Ndërkombëtare dhe Banka Shumëpalëshe të Zhvillimit
	QR & AL & NJP	Qeveri Rajonale, Autoritete Lokale dhe Njësi të Sektorit Publik
	SIS	Bankë Sistemike brenda vendit dhe grupi i personave të lidhur me të, që janë subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar të Bankës së Shqipërisë
4	Emërtimi i grupit të palëve të lidhura	Vendoset një emërtim përmbledhës për grupin e palëve të lidhura dhe përsëritet i njëjti emërtim për çdo ekspozim individual të raportuar.
5	Numri i klientit në varësi të tipologjisë së ekspozimit	Përmban numrin e ekspozimit individual kur ai është pjesë e një grupi të lidhur. Kjo kolonë plotësohet vetëm për ekspozimet që në kolonën "Tipologjia e ekspozimit" kanë marrë kodin GPL, GIML, GIMLG, GPLG. Për vlerën e parë të çdo grupi, të zgjidhet opsioni "Total". Në vijim, për çdo ekspozim përbërës të grupit të zgjidhet nga një numër rendor, duke filluar nga numri 1, me qëllim identifikimin e numrit të ekspozimeve të grupit.
6	Tipologjia Kontabile	Përmban përcaktimin e natyrës kontabile të regjistruar duke ndarë zërat e librit të bankës dhe zërate librit të tregueshëm.
	ZLB	Zë i Librit të Bankës
	ZLT	Zë i Librit të Treguesh ëm
	ZLB + ZLT	Kjo zgjedhje bëhet kur ekspozimi ndaj klientit ose grupit i përmban të dy llojet e tipologjisë kontabile
7	Renditja e ekspozimeve	Përcaktohet renditja së cilës i përket ekspozimi. Renditja bëhet duke vendosur nr. 1 për ekspozimin më të madh të grupit e kështu me radhë. Referuar nenit 11 të rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha", në këtë kolonë numri rendor duhet të arrijë të paktën 20, dhe më shumë se 20 nëse grupi ka më shumë se 20 ekspozime të mëdha që tejkalojnë nivelin prej 10% të kapitalit rregullator të grupit dhe njëkohësisht ato që tejkalojnë nivelin prej 10% të kapitalit të nivelit të parë të grupit Për rastet e grupeve të lidhura, për secilin prej ekspozimeve të të njëjtit grup, vendoset i njëjti numër rendor të cilit i korrespondon renditja e ekspozimit të grupit
8	Renditja e ekspozimeve më të mëdha të grupit ndaj institucioneve të Mbikëqyrura	Përcaktohet renditja së cilës i përket ekspozimi ndaj një institucioni të mbikëqyrur (përfshirë edhe ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura me marrëdhënie të veçantë me grupin). Renditja bëhet duke vendosur nr. 1 për ekspozimin më të madh të grupit ndaj institucionittë mbikëqyrur, e kështu me radhë. Referuar nenit 11 të rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha", në këtë kolonë numri rendor duhet të arrijë të paktën 10, dhe më shumë se 10 nëse grupi ka më shumë se 10 ekspozime të mëdha ndaj institucioneve të mbikëqyrura që tejkalojnë nivelin prej 10% të kapitalit rregullator të grupit dhe njëkohësisht ato që tejkalojnë nivelin prej 10% të kapitalit të nivelittë parë të grupit. Për rastet e grupeve të lidhura të institucioneve të mbikëqyrura (me kodin GIML ose GIMLG), për secilin prej ekspozimeve të të njëjtit grup vendoset i njëjti numër rendor të cilit i korrespondon renditja e ekspozimittë grupit të institucioneve të mbikëqyrura.
9	Emri i klientit	
10	NUIS / Numër identifikimi	Për çdo klient vendoset një numri identifikimi unik. Për rastet e ekspozimeve që janë të raportuara në regjistrin e kredisë, vendoset NUIS-i, i njëjtë me atë të raportuar në regjistrin e kredive. Përndryshe banka raportuese vendos një numër identifikimi të vetin.
11	Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (vetëm për ZLB)	Shuma e ekspozimit, e logaritur në përputhje me nenin 5 të rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha", e zmadhuar përshumën e ekspozimit, si rezultat i zëvendësimit sipas nenit 9 të rregullores së sipërcituar (pjesë nga ekspozimi i garantuar nga një palë e tretë ose i siguruar me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë, i cili është trajtuar si ekspozim ndaj garantuesit ose lëshuesittë kolateralit) vetëm për zërate librit të bankës.
	Pozicionet në instrumente finanoiare (vetëm për ZLT)	Vlera e pozicioneve në blerje dhe në shitje, e të gjithë instrumenteve financiare, të lëshuar nga personi/klienti në fjalë, ku pozicionet neto, për secilin instrument financiar, janë përllogaritur në përputhje me rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" (Kreu VII - Rreziku i Tregut). Kur përllogaritet ekspozimi ndaj një personi/klienti individual si rezultat i pozicioneve në instrumente të ndryshme financiare, mbidhen pozicionet neto për instrumentet e ndryshme financiare të këtyre personave/klientëve. Kolonat 12, 13 dhe 14 plotësohen vetëm për zërat e librittë tregtueshëm.
12	Në blerje	Pozicioni në blerje në instrumente financiare
13	Në shitje	Pozicioni në shitje në instrumente financiare
14	Në blerje neto	Pozicioni në blerje neto në instrumente financiare
	Pozicionet në instrumente finanoiare në raste të nënshkrimit me premtimin për të blerë (vetëm për ZLT)	Shuma e ekspozimit që lind nga angazhimi për të blerë instrumente financiare të personave/klientëve individualë, në rastin e përgatitjes dhe finalizimit të nënshkrimit, e reduktuar për shumën e instrumenteve financiare, të cilët u janë transferuar tashmë, palëve të treta dhe ekspozimi neto i përllogaritur (diferenca). Kolonat 15, 16 dhe 17 plotësohen vetëm për zërat e librit të tregtueshëm.
15	Premtimi për të blerë	Angazhimi/premtimi për të blerë
16	Transferuar një personi të tretë	Shuma e instrumenteve financiare, të cilët u janë transferuar palëve të treta
17	Diferenca	Ekspozimi neto i përllogaritur
18	Ekspozimi i rrezikut të kredisë së kundërpartisë (vetëm për ZLT)	Ekspozimet ndaj një personi/klienti individual, si rezultat i transaksioneve, marrëveshjeve ose kontratave, që kanë të bëjnë me rrezikun e kundërpartisë, të përllogaritura në përputhje me metodat parashikuara në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".
19	Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (vetëm për ZLT)	Shuma e ekspozimeve të paraqitura në kolonat 14, 17 dhe 18, për zërate librit të tregtueshëm.

20	Ekspozimi i përgjithshëm përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (ZLB+ZLT)	Totali i kolonave 11 dhe 19 (për zërat e librit të bankës dhe të librit të tregtueshëm.)
21	Nga i cili (20): Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë i ardhur nga zëvendësimi	Pjesa e ekspozimit e garantuar nga një palë e tretë ose e siguruar me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë, e cila trajtohet si një ekspozim ndaj garantuesit ose lëshuesit të kolateralit - përdorimi i zëvendësimit në përputhje me nenin 9 të rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha" (shuma e përfshirë në kolonën 20).
22	Nga i cili (20): Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë i ardhur nga shuma e kredive (vetëm për ekspozimet e kategorive IMLG, GIMLG, KILG dhe GPLG)	Do të plotësohet vetëm për vlerën e ekspozimit, të raportuar në kolonën 20, në formën e kredisë ndaj kategorive IMLG, GIMLG, KILG dhe GPLG, në kuptim të nenit 131 të ligjit për bankat.
23	Përqindja ndaj kapitalit rregullator të grupit përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Vlera e ekspozimit të raportuar në kolonën 20, në raport me kapitalin rregullator të grupit në datën e raportimit.
24	Përqindja ndaj kapitalit të nivelit të parë të grupit përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Vlera e ekspozimit të raportuar në kolonën 20, në raport me kapitalin e nivelit të parë të grupit në datën e raportimit.
25	Mbrojtja e pafinancuar e kredisë	Shuma e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, e cila, në përputhje me shkronjën "c", pjesërisht me shkronjën "d" dhe pjesërisht me shkronjën "e", të pikës 2 të nenit 8 dhe pikën 2 të nenit 9 të rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha", mund të përdoret për të përcaktuar nëse janë arritur kufijtë maksimalë të lejueshëm të ekspozimit.
26	Mbrojtja e financuar e kredisë	Shuma e mbrojtjes së financuar të kredisë e cila, në përputhje me shkronjat "f" dhe "g" të pikës 2 të nenit 8 dhe pikës 3 të nenit 9 të rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha", mund të përdoret kur përcaktohet nëse janë arritur kufijtë maksimalë të lejueshëm të ekspozimit.
27	Përjashtime dhe reduktime	Shuma e përjashtimeve në përputhje me shkronjat "a", "b", pjesërisht shkronjën "d", pjesërisht shkronjën "e" dhe shkronjat "h", "i", "j", "l", "m", "n" dhe "p", të pikës 2 të nenit 8 të rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha".
28	Ekspozimi pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë për ZLB	Vlera e ekspozimit, e llogaritur në përputhje me kërkesat e rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha", pas reduktimeve, përjashtimeve dhe aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, për zërat e librit të bankës.
29	Ekspozimi i përgjithshëm pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Vlera e ekspozimit të përgjithshëm (për zërat e librit të bankës dhe të librit të tregtueshëm), e llogaritur në përputhje me kërkesat e rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha", pas reduktimeve, përjashtimeve dhe aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë.
30	Kapitali rregullator i grupit në datën e raportimit	Shuma e kapitalit rregullator të grupit në datën e raportimit.
31	Kapitali i nivelit të parë të grupit në datën e raportimit	Shuma e kapitalit të nivelit të parë të grupit në datën e raportimit.
32	Përqindja ndaj kapitalit rregullator, pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Vlera e ekspozimit të raportuar në kolonën 29, në raport me kapitalin rregullator të grupit në datën e raportimit.
33	Përqindja ndaj kapitalit të nivelit të parë, pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Vlera e ekspozimit të raportuar në kolonën 29, në raport me kapitalin e nivelit të parë të grupit në datën e raportimit.
34	Kufiri maksimal i lejueshëm	Në këtë kolonë përcaktohen kufijtë maksimalë të lejueshëm të ekspozimeve, në varësi të natyrës së ekspozimit të përcaktuar në kolonën 3.
35	Tejkalimet e kufirit maksimal të lejueshëm	Kjo kolonë plotësohet automatikisht vetëm nëse ekspozimi tejkalon kufirin maksimal të lejueshëm.
36	Ekspozimet e mëdha që janë mbi 10% e kapitalit rregullator të grupit	Në këtë kolonë do të evidentohen automatikisht të gjitha ekspozimet e mëdha (kolona 29) që tejkalojnë 10% të kapitalit rregullator të grupit.
37	Matja e shumës së ekspozimeve të mëdha që janë mbi 10% e kapitalit rregullator të grupit	Në këtë kolonë do të bëhet vlerësimi automatik i: a) Shumës së ekspozimeve të raportuara në kolonën 36; b) Raportit kësaj shume me kapitalin rregullator të grupit; c) Vlerësimi i respektimit të kufirit maksimal prej 700% të shumës së këtyre ekspozimeve ndaj kapitalit rregullator të grupit.
38	Matja e ekspozimeve të kredive për kategoritë e kundërpartive të lidhura me grupin (IMLG, GIMLG, KILG dhe GPLG)	Në këtë kolonë do të bëhet vlerësimi automatik i: a) Shumës së kredive të raportuara në kolonën 22; b) Raportit kësaj shume me kapitalin rregullator të grupit; c) Vlerësimi i respektimit të kufirit maksimal prej 100% të shumës së këtyre kredive ndaj kapitalit rregullator të grupit.